



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 38
Prishtinë, 21 prill 2009, ora 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Armend Zemaj, Nurishahe Hulaj, Bujar Bukoshi dhe Qamile Morina.

Munguan: Mimoza Ahmetaj, Gjylnaze Sylja dhe Sllobodan Petroviq.

Të pranishëm:

Nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (në vazhdim MPMS): Gjylnaze Novobërdaliu - Gola dhe Minire Begaj.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri.

Nga KDI-ja: Rrezarta Ahmeti dhe Driton Selmanaj.

Nga OSBE-ja: Lejla Selimi.

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës

Sadik Idriz – Tha se grupi i punës lidhur me shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës është takuar dhe ka bërë amendamentimin e këtij Projektligji. Gjithashtu ky grup pune ka propozuar që për disa nene nevojitet konsultimi me MPMS-në. Kjo është arsyeja, pse Komisioni ka ftuar në takim përfaqësues nga MPMS-ja. Sa i përket dilemës nëse ky ligj duhet të kalojë ose jo, Komisioni diskutoi dhe Kuvendi e miratoi në parim. Hapi diskutimin.

Qamile Morina – Theksoi se edhe para miratimit në parim ka qenë kundër procedimit të mëtuftjeshëm të këtij Projektligji, sepse nuk ka ligj bazë të punës. Ky Projektligj nuk parasheh kritere që do të bënin dallimin ndërmjet të punësuarve dhe të vetëpunësuarve. MPMS-ja në mbledhjen kur është shqyrtuar në parim ky Projektligj, arsyetimin e ka bërë me qëllim kryesor që kinezët, të cilët punojnë në Kosovë, të regjistrohen që ta dimë numrin e tyre. Është paraparë që ky ligj t'u drejtohet institucioneve private dhe shtetërore. Ky nen me propozimamendamentin e grupit të punës është hequr dhe si rezultat i kësaj do të kemi problem, sepse të punësuarit e huaj kanë për të hyrë edhe në institucionet publike për të punuar, nëse nuk do të kemi kritere që do t'i përcaktonin qartë të punësuarit dhe të vetëpunësuarit. I vetmi kriter që përcakton numrin e të punësuarve në Kosovë është e drejta e posaçme e Qeverisë për përcaktimin e numrit të të punësuarve, shtetas të huaj. Ligji nuk është i qartë.

Flora Brovina - Tha se Ky Projektligj nuk rregullon punësimin e shtetasve të huaj, por rregullon lejet për punësim. Titulli i ligjit nuk përshtatet me përmbajtjen. Si anëtare e grupit të punës kam propozuar që t'i presim edhe vërejtjet eventuale nga deputetët, anëtarë të Komisionit, e pastaj grupi i punës të merret me analizën e atyre propozimeve. Propozimamendamenti i deputetes Nurishahe Hulaj është shumë i gjatë. Amendamentet e propozuara deri më tani nuk mjaftojnë për këtë ligj.

Teuta Hadri – Theksoi se e ka përkrahur këtë Projektligj që në leximin parë. Është një projektligj shumë i mirë dhe Kosova ka nevojë për rregullimin e kësaj fushe. Sa i përket amendamentimit të titullit të këtij Projektligji, Komisioni nuk ka të drejtë ta bëjë këtë, sepse Projektligji me këtë titull është miratuar në parim nga Kuvendi. Sa u përket kritereve - në nenin 7, saktë është përcaktuar se cilat kritere duhet të plotësohen. E mbështes këtë Projektligj me titullin e paraqitur nga MPMS-ja.

Nurishahe Hulaj – Tha se në leximin e parë të këtij Projektligji në Kuvend janë bërë vërejtje konkrete dhe për këtë ekziston transkripti. Nga përmbajtja e këtij Projektligji, 85 % e tij, ka të bëjë me dhënie lejeve për punë. Nga rekomandimet e përgjithshme kam nxjerrë propozimin se Projektligji nuk rregullon kërkesën për leje të punës para themelimit të marrëdhënies së punës. Pra, titulli i Projektligjit duhet të amendamentohet si vijon: *“Projektligji për dhënie lejeve për punë shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi në Republikën e Kosovës”*.

Armend Zemaj – Tha se ky Projektligj ka kaluar leximin e parë dhe ne mund të diskutojmë për amendamentet konkrete. Çështjet që kanë të bëjnë me atë se çka rregullon ky ligj, janë diskutuar në këtë Komision dhe tani nuk duhet të jetë temë diskutimi. Sa i përket propozimit për

amendamentimin të titullit, atë mund ta bëjmë, por edhe ky amendament që është propozuar është shumë i gjatë. Në titull nuk ka nevojë të përfshihen personat pa shtetësi. Ky propozim duhet të modifikohet. Ky ligj duhet të kalojë, pavarësisht se të gjithë e presim ligjin e punës, sepse rregullon një materie tjetër dhe një fushë tjetër.

Rita Hajzeraj – Shtoi se të gjithë pajtohem se ligji për punën është më i rëndësishëm dhe është dashur të procedohet para Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj. Mirëpo, duke pasur parasysh nevojën për këtë ligj dhe se ligji për punën do të procedohet në Kuvend këtë vit, ne jemi pajtuar që ky Projektligj ta kalojë leximin e parë. Përmbajtja e këtij Projektligji nuk përkon me titullin e ligjit. Po ashtu propozimamendamenti i deputetes Nurishahe Hulaj është shumë i gjatë, andaj propozoi që titulli i Projektligjit të amendamentohet si vijon: *“Ligji për dhënien e lejeve për punë dhe punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës”*.

Qamile Morina – Nëse shkojmë me propozimin *“Ligji për dhënien e lejeve për punë”*, atëherë leja për punë jepet para se shtetasi i huaj të gjejë punën dhe shteti i Kosovës detyrohet që t’ia gjejë punën. Me Ligjin për të huajt është përcaktuar se shtetasi i huaj lejen e qëndrimit e merr pasi ta ketë marrë lejen për punë.

Gjynaze Novobërdaliu - Gola – MPMS – Tha se ekziston Ligji për nxitjen e punësimin dhe mbrojtjen e punëkërkuesve, në të cilin saktësohen kriteret për vetëpunësim. Së pari duhet të merret leja e qëndrimit, pastaj leja për punë. Secili shtet e përcakton kuotën për politikën e punësimin. Më vonë do të nxirren udhëzime përkatëse për përcaktimin e kriterëve për llojin e lejeve të punës. Sa i përket ligjit për punë vetëm një nen i referohet Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj.

Minire Begaj – MPMS - Shtoi se asnjë i huaj nuk mund të pajset me leje të punës, pa pasur leje të qëndrimit në Kosovë.

Qamile Morina - Tha se Ligji për të huajt i Pakos së Ahtisarit, thotë se së pari duhet të sigurohet leja e punës, e pastaj leja e qëndrimit.

Sidik Idriz – Theksoi se jemi në fazën e amendamentimit të Projektligjit dhe jo të diskutimit, ka, a nuk ka nevojë për ligjin, sepse seanca e ka miratuar në parim Projektligjin. Presim propozime konkrete për amendamentim.

Ky ligj përfshin vetëm çështjen e punësimin të të huajve, çështjet tjera rregullohen me ligje të tjera. Kosova nuk ka bazë ligjore për rregullimin e punësimin të të huajve dhe ky ligj do ta rregullojë çështjen e punësimin të të huajve, në mënyrë që ata t’i paguajnë tatime shtetit.

Minire Begaj - Tha se titulli i ligjit përkon me përmbajtjen, sepse përmbajtja dhe qëllimi i ligjit është punësimi i të huajve, ku përfshihet edhe procedura e marrjes së lejes për punësim. Me akte nënligjore do të specifikohen çështjet tjera të punësimin të të huajve.

Teuta Hadri – Shtoi se kemi shumë të huaj që punojnë në Kosovë, regjistrojnë një biznes tjetër dhe merren me çështje të tjera, si çështje fetare etj.

Qamile Morina - Tha se duhet të diskutojmë që ligji të jetë sa më i mirë dhe t’i mbrojë edhe punëtorët e vendit tonë. Me përfaqësues të Ministrisë duhet t’i diskutojmë dilemat të cilat i kemi.

Bujar Bukoshi - Më mirë është ta kemi një ligj, sesa të mos kemi ligj fare. Nëse nuk do të ishte i mirë në praktikë, do ta amendamentonim sipas nevojës.

Sadik Idriz - Propozoi që deri në mbledhjen e ardhshme t'i bëjnë propozimet konkrete me shkrim dhe në mbledhjen e radhës të miratohen amendamentet.

Gjynaze Gola - Tha se nuk pajtohet me propozimin e deputetit Riza Smaka, në nenin 21, paragrafi 5. Nuk mendoj se konflikti administrativ duhet të shkojë në Gjykatën Supreme, por në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh.

Nurishahe Hulaj – Theksoi se në nenin 18, thuhet: *për legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë*, ndërsa legjislacioni aktual i Kosovës nuk u referohet të huajve.

Gjynaze Gola – Vuri në pah se mund të hiqet fjala *aplikueshëm* dhe se të gjitha marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjet në fuqi, si për vendas, ashtu edhe për të huajt.

Te gjohet pajtohem që në vend të *gjobat*, të bëhet *dënimi me të holla*, por jo *dënimet me të holla* në titullin e nenit, kurse titulli të bëhet *dispozitat ndëshkuese*.

Gjohet mund të jenë më të larta, ose mund të jenë në pajtim me Ligjin për Inspektoratin e Punës.

Rita Hajzeraj - Tha se titulli i ligjit nuk korrespondon me përmbajtjen e tij. Në qëllim të ligjit nuk përmenden lejet e punës, ndërsa në brendi të ligjit flitet vetëm për lejet e punës.

Minire Begaj - Tha se pikat e *nenit 13*, duhet të specifikohen. *Pika 1.12* e këtij neni është marrë nga ligji i Kroacisë.

Të ndryshme

Sadik Idriz - Për këtë pikë kemi pranuar një shkresë nga banorët e fshatit Karaçevë. Hap diskutimin për këtë shkresë.

Flora Brovina - Tha se kam pasur një takim me disa banorë të fshatit Karaçevë, të komunës së Kamenicës. Siç jeni të informuar para disa ditëve qentë endacakë kanë plagosur një djalë 11 vjeçar, i cili nga plagët ka vdekur. Banorët ishin të tronditur nga kjo ngjarje. Kërkesa e tyre ishte ta ngremë këtë çështje në mbrojtje të qytetarëve.

Teuta Hadri - Ne si Komision nuk mendoj se mund t'u dalim në ndihmë. Janë organet kompetente, si komunale, ashtu edhe të Qeverisë dhe të policisë, që janë të detyruara të merren me këtë çështje.

Rita Hajzeraj - Më duket e drejtë kërkesa e këtyre banorëve, sepse kërkesa e tyre është edhe për ndihmë materiale. Pasi jemi Komision për Punë dhe Mirëqenie Sociale, t'i dalim në ndihmë kësaj familje, duke kërkuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale t'i ndihmojë, pasi e ka gjendjen e vështirë materiale.

Nurishahe Hulaj - Pajtohem të kërkojmë nga Ministria ta ndihmoj në mënyrë materiale këtë familje.

Sadik Idriz - Tha se kjo shkresë nuk është në fushëveprimin tonë. Janë organet kompetente të policisë dhe të komunës që do të merren me këtë çështje. Sa i përket përkrahjes materiale, mund ta shqyrtojmë, por kemi mijëra familje në Kosovë, që e kanë gjendjen e vështirë materiale. Ne nuk mund t'u dalim të gjithëve në ndihmë, sepse do të kishim me mijëra kërkesa.

Qamile Morina – Komisioni ynë mund ta përkrahë moralisht këtë familje, pastaj t'i rekomandojmë Ministrisë ta përkrahë.

Rita Hajzeraj - Tha se ne vetëm t'i rekomandojmë Ministrisë, që brenda mundësive t'i ndihmojë materialisht kësaj familje. Për çështje të tjera nuk jemi kompetentë.

Bukjar Bukoshi - Kjo shkresë duhet t'i dërgohet komunës, ndërsa Komisioni t'ia kthejë një shkresë palës se Komisioni e përkrah këtë familje. Shkresën do ta përcjellë në organet kompetente.

Flora Brovina – Propozoi që Komisioni t'ia përcjellë shkresën Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, që mundësisht ta ndihmojë këtë familje.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 30.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Sadik Idriz